



INSTITUTI HIDROMETEOROLOGJIK I KOSOVËS

31/05/2023

01/2023/ihmk

Buletin

SITUATA AKTUALE HIDROMETEOROLOGJIKE DHE TRENDET PËR MUAJT E VERËS

Përgatitur nga:

Dr. Bashkim Kastrati – Hidrolog
MSc. Besim Aliu - Meteorolog



Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
Rruga "Lidhja e Pejës. Nr. 47
10000. Prishtinë

Tel: +383 038 60 384
<http://ihmk-rks.net/>
ihmk@rks-gov.net

Sektori i Hidrologjisë
bashkim.kastrati@rks-gov.net
Mob: +383 44 25 65 52

Hyrje

Kosova gjeografikisht shtrihet në pjesën jugë-lindore të Evropës (Ballkani perëndimorë), ndërsa në aspektin klimatik, bën pjesë në brezin e gjerësive të mesme gjeografike të hemisferës veriore. Kosova edhe pse ka territor relativisht të vogël, ajo veçohet me reliev të përthyer dhe topografi karakteristike, duke u përbërë në njërën anë prej maleve të larta periferike të cilat dallohen sipas shtrirjes, ekspozicionit, formës etj. dhe në anën tjetër prej zonave kodrinore malore dhe fushëgropave¹ si dhe luginave të përshkuara nga rrjedhat ujore të cilat kanë ndikuar në formimin e rrjetit hidrografik dhe zhvillimin e botës bimore. Këto kushte dhe para dispozita natyrore, janë përcaktuar si faktorë të rëndësishëm të modifikimeve klimatike dhe formimit të disa tipave të klimës lokale. Kështu në kuadër të faktorëve gjeografik, të cilët ndikojnë në klimën e Kosovës janë: *pozita e sajë në raport me sipërfaqet ujore dhe kontinentale, pozita ndaj sistemeve barike globale, faktorët lokal etj.*

Temperaturat

Treguesi më i rëndësishëm i motit dhe i klimës është temperatura e ajrit
Në tabelë janë dhënë vlerat e temperaturave sipas Stacioneve Automatike Meteorologjike
Për muajt janar – Maj 2023.

Tabela 1. Vlerat e temperaturave Janar – Maj 2023

	Dragash	Ferizaj	Gjakove	Istog	Junik	Kamenice	Malishevë	Peje	Prishtine	Prizren	Podujevë
<i>Mes</i>	4.8	6.3	7.7	7.2	7.4	6.2	7.0	7.5	7.0	7.9	5.9
<i>Max</i>	21.8	24.0	26.0	24.1	25.3	26.7	25.8	24.7	25.8	25.6	24.0
<i>Min</i>	-13.8	-10.6	-7.1	-9.5	-8.9	-11.6	-10.1	-8.6	-10.0	-9.5	-9.9

Temperatura mesatare Janar – Maj, 2023, ishte 6.8 °C, ndërsa ajo mesatare shumëvjeçare 6.4°C, ndërsa vlerat mesatare maksimale gjate këtyre muajve ishin 24.9°C, apo afro 9.8 °C me e nxehët se mesatarja maksimale shumëvjeçare. Gjatë këtyre muajve, vlera me e lartë e temperaturave është regjistruar në Kamenicë 26.7 °C, me datë 07.05.2023.

Trendët aktuale, sezonale dhe prognozatat gjatë muajve të verës në Kosovë


Duke u nisur nga fakti i ngjarjeve të pazakonta të motit, fillimisht me dimër relativisht të butë e përcjellë sidomos me reshje të shiut, të cilat vetëm gjatë Janarit të këtij viti, (17 – 20.01.2023), kishin rënë rreth 144 mm, apo më shumë se gjysma e sasisë mesatare për këtë muaj, duke shkaktuar vërshime masive me dëme të konsiderueshme nëpër disa zona të Kosovës, sidomos në Skenderaj, Mitrovicë, Klinë, Istog etj. Pastaj muajt shkurt – mars – Prill, u karakterizuan me temperatura relativisht të larta, mbi mesatare për këtë periudhë, gjegjësisht për kushtet aktuale sezonale. Prandaj këto janë ngjarje dhe trende globale, me të cilat çdo ditë e më shpesh po ballafaqohet jo vetëm Kosova por edhe vendet tjera të rajonit, Evropës dhe gjithë planetit, të cilat vijën si pasojë e ndryshimeve klimatike. Këto anomali klimatike, në vazhdim mund dhe pritët të jen edhe më të ashpra dhe me pasoja edhe më të mëdha, të tilla si temperatura ekstreme, vërshime, dimra të butë dhe me reshje shiu, stuhi dhe rrebeshe të shiut, rëna më të fuqishme etj., të cilat padyshim që do të kenë efekte dhe ndikime në shëndetin tonë, në resurset ujore, bujqësi, komunikacion, botën e gjallë (bimore dhe shtazore), mjedis etj.

¹ Maja më e lartë në Kosovë, Gjeravica 2656 m, më e ulëta lugina e Drinit të bardhë në Vërbnicë 265 m.

Prandaj, Sistemet e Parashikimi dhe të Paralajmërimit të Hershëm, kanë rëndësi të veçantë në informimin me kohë dhe të saktë të institucioneve përgjegjëse, qytetarëve, mediat etj., në mënyrë që të jemi më të përgatitur dhe për të reaguar me kohë ndaj situatave të tilla.

Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, përkundër kapaciteteve të saja të limituara teknike dhe humane, në vazhdimësi e ka bërë dhe do ta bëjë edhe në të ardhmen informimin, përmes “Parashikimit dhe paralajmërimit të Hershëm” të institucioneve dhe qytetarët, për kushtet e motit si dhe për vërshimet si dhe për rreziqet tjera me karakter hidroklimatik.

Grafiku 1. Sasia e reshjeve për Janar – Prill për disa stacione Meteorologjike në Kosovë



Grafika shfaqin sasinë e reshjeve janar – prill 2023, nga vërejmë që sasia më e lartë e tyre ka qenë në Junik prej 602.9 mm, pastaj Peja me 341.9, Istogu me 302.8 e kështu me radhë. Krahasuar me mesataren shumëvjeçare, gjatë këtyre muajve kemi pasur për afro 170 % ose 214.6 mm reshje më tepër se mesatarja.

Probabilitetit (gjasat) klimatike për muajt në vijim

Edhe pse parashikimet dhe prognozatat afatgjate meteorologjike, klimatike dhe hidrologjike, janë shumë të vështira për tu bërë, ndërsa për disa parametra klimatike pothuajse të pamundura për tu parashikuar, prapëseprap, modelet globale dhe teknologjia aktuale, mundëson një gjë të tillë me probabilitetet të kufizuara nga modelet individuale dhe ato globale. Probabilitetet individuale të modeleve vlerësohen duke krahasuar funksionin e densitetit të probabilitetit të parashikimit me modelin korrespondues të klimës. Probabilitetet janë të kategorizuara sipas: mesatares, (poshtme, mesme, sipërme dhe 20% më të ulët më të lartë të shpërndarjes së modelit klimatik). Ndërsa pasqyrimi apo parashikimi sezonal, paraqitet një grafik përmbledhës për kategoritë të caktuara, të cilat tregojnë zonat që kanë një probabilitet të rritur (mbi 40%) për të qenë apo ndodhur një ngjarje në realitet. Produktet e ofruara kanë referencë (hindcast²) nga European Centre for Medium-Range Weather Forecasts (ECMWF), Met Office, Météo-France, DWD), modeli SPI etj.

² "Parashikimi" i modelit për kohët e mëparshme quhet "hindcast".

Po ashtu janë të rëndësishme edhe kontributet e qendrave nacionale dhe individuale të rrjetave monitoruese të kombinuara ku secila prej tyre ofron informacione. Informacionet e prodhuar nga shërbimi i ndryshime si psh Copernicus, i cili përdorë të dhënat satelitore, pastaj parashikimet nga Qendrat Kombëtare të SHBA), Agjencia Meteorologjike Japoneze, Agjencia e Mjedisit dhe Ndryshimeve Klimatike e Kanadasë, janë ndër kontribuuesit për ofrimin e të dhënave dhe shërbimeve të ndryshme.

Parashikimi për verën evropiane 2023

Zonat barike që e kontrollojnë motin mbi vendin tone dhe gjithë Evropën janë: Anticikloni i Azoreve, Anticikloni i Siberisë, Cikloni i Islandës dhe masat e nxehta të ajrit që vijnë verës nga Afrika Veriore. Stinët ndahen në dy mënyra, në stinë Meteorologjike dhe në stinë Astronomike. Sipas stinëve meteorologjike vera 2023 me 1 qershor dhe përfundon me 1 shtator. Stina e verës 2023 parashihet me temperature mesatare minimale dhe maksimale mbi mesataret shumëvjeçare, kjo si pasojë e efekteve më të shpeshta të El Nino (faza e ngrohtë e lëkundjeve). Parashihen edhe ditë më të shpeshta me breshër, si pasojë e temperaturave të larta. Gjithashtu edhe shkalla e avullimeve do të jetë e lartë për shkak të temperaturave dhe erërave të cilat do të jenë të shpeshta dhe masat e ajrit do të jenë në të shumten e kohës dinamike.

Qershori

Muaji qershor parashihet të ketë insolacion më të theksuar pavarësisht se edhe reshjet e shiut nuk do të mungojnë, ku vrehet edhe nga SPI6. Mesatarja e insolacionit (ditë me diell), parashihet të jetë rreth 7h. Temperatura mesatare minimale për muajin qershor parashihet të jetë mbi vlerat e mesatareve shumëvjeçare. Vlera mesatare e saj parashihet të jetë rreth 0.5 °C më e lartë në krahasim me mesataren shumëvjeçare. Në rrafshin e Kosovës, temperature mesatare për muajin qershor parashihet të jetë rreth 19-21 °C, ndërsa në rrafshin e Dukagjinit temperature mesatare mujore parashihet të jetë 20-22 °C (duke i përfshirë edhe mesataret e stacioneve në viset e larta malore). Sasitë e reshjeve në rrafshin e Kosovës parashihen të lëvizin ndërmjet 25-35mm përfshirë zonat e lindjes, juglindjes dhe verilindjes, ndërsa në Jug, jugperëndim, perëndim, veri dhe veriperëndim, sasitë e reshjeve parashihen të lëvizin ndërmjet 40-75mm. Sasitë e avullimeve parashihen të jenë rreth trefish në raport me sasinë e reshjeve.

Korriku

Muaji korrik si zakonisht do të ketë më shumë orë me diell, parashihen që mesataret ditore të jenë mbi 9h dhe më pak vranësira të stadi të ulët të Troposferës. Temperatura minimale e ajrit në ketë muaj do të ketë vlera mbi mesataren shumëvjeçare, ku vlera mesatare mujore e saj do të jetë rreth 0.6 gradë më e lartë në krahasim me mesataren shumëvjeçare. Në rrafshin e Kosovës temperatura mesatare minimale parashihet të jetë rreth 15 gradë Celsius, ndërsa në rrafshin e Dukagjinit rreth 15.5 gradë Celsius.

Temperatura mesatare maksimale do të jetë rreth 29.5 °C, ndërsa në Dukagjin rreth 30-30.5°C. Këto vlera të parashikuara në raport me vitet e fundit janë për afro 1 gradë më të larta. Kurse temperatura mesatare mujore për muajin korrik parashihet të jetë rreth 22 gradë në rrafshin e Kosovës, ndërsa rreth 23 gradë në rrafshin e Dukagjinit. Sasitë e reshjeve parashihen të jenë më të ulëta në krahasim me mesataren e viteve tjera, ku sasitë totale parashihen të jenë 20-30mm në rrafshin e Kosovës, ndërsa në Dukagjin rreth 30-40mm. Shkalla e avullimeve gjithashtu parashihet të jetë e lartë rreth 4-5 herë më e lartë se sasitë e reshjeve.

Gushti

Muaji gusht parashihet me temperature më të larta për 0.5-1 °C në krahasim me mesataret shumëvjeçare. Në rrafshin e Kosovës temperaturat minimale mesatare parashihen të jenë rreth 15 gradë Celsius, ndërsa në Dukagjin rreth 16 °C. Temperatura maksimale mesatare e ajrit parashihet të jetë mbi mesataren afatgjate për 0.8-1.1 gradë Celsius, në krahasim me mesataren afatgjate. Parashihen rreth 9h me diell të jetë mesatarja ditore dhe në total rreth 290h. Në rrafshin e Kosovës temperatura mesatare maksimale parashihet të jetë ndërmjet 29-30°C, ndërsa e njëjta në rrafshin e Dukagjinit parashihet të jetë ndërmjet 30-31°C. Sa i përket sasisë totale të reshjeve gjatë muajit gusht parashihet të ketë më pak reshje se mesataret shumëvjeçare. Në rrafshin e Kosovës sasi të reshjeve parashihen të jenë rreth 30-35mm, ndërsa në rrafshin e Dukagjinit sasi të reshjeve parashihen të jenë ndërmjet 35-55mm. Gjatë stinës së verës 2023 pos këtyre ngjarjeve të reflektuara, parashihen edhe ditë me breshër dhe erëra të furishme (stuhi).Këto ngjarje zakonisht ndodhin në pjesën e dytë të ditës, nga ora 14-17, si pasojë e amplitudave të mëdha në fushat barike por edhe ato termike.

Parashikimi sezonal C3S³ i inicializuar afër 1 majit tregon probabilitet të shtuara për reshje mbi mesataren mbi Evropën Jugore për verën në tërësi (qershor-gusht). Ky sinjal vjen nga fillimi i sezonit dhe është i pranishëm në disa (jo të gjithë) komponentët e multi-sistemit C3S (*shih grafikët individual të parashikimit*). Anomalitë e parashikuara në pamjen e grafikeve janë të vogla; në realitet, sasi të tilla të shiut nuk do të bënin një ndryshim domethënës në kushtet e thatësirës e cila mund të paraqitet në disa rajone të Evropës. Për temperaturën, sinjali është për vlerat sezonale mbi mesataren pothuajse në të gjitha zonat tokësore, më e shprehur në Evropën Jugore dhe Perëndimore. Parashikimet për temperaturën e sipërfaqes së detit në Paqësorin ekuatorial vazhdojnë të tregojnë pothuajse të sigurt zhvillimin e një ngjarjeje El Niño⁴ gjatë pjesës së dytë të këtij viti. Në kohën e formimit, kushtet rreth Tropikëve nuk tregojnë një përgjigje atmosferike ndaj këtyre kushteve të oqeanit, që do të thotë se ngjarja në të gjithë Paqësorin, nuk ka filluar ende, dhe kështu ndikimet në zonat e largëta nga qendra e veprimit, nuk ka gjasa të hyjë në fuqi para fundit të verës. Kjo do të thotë që efekti i një El Nina, do të vazhdojë edhe me tutje gjatë stinës së vjeshtës.


³ C3S është një program operacional, që ofron të dhëna autoriteteve dhe të standardizuara për klimën e kaluar, të tashmen dhe të ardhshme, si dhe mjete për të mundësuar strategjitë e zbutjes dhe përshtatjes së ndryshimeve klimatike nga politike bërësit dhe bizneset.

⁴ El Niño dhe La Niña janë modele klimatike në Oqeanin Paqësor që mund të ndikojnë në motin në mbarë botën. Gjatë kushteve normale në oqeanin Paqësor, erërat fryjnë në perëndim përgjatë ekuatorit, duke marrë ujë të ngrohtë nga Amerika e Jugut drejt Azisë. Për të zëvendësuar atë ujë të ngrohtë, uji i ftohtë ngrihet nga thellësia - një proces i quajtur ngritje. El Niño dhe La Niña janë dy modele klimatike të kundërta që thyejnë këto kushte normale. El Niño dhe La Niña mund të kenë ndikime globale në mot, ekosisteme dhe ekonomi. Episodet e El Niño dhe La Niña zakonisht zgjasin nëntë deri në 12 muaj, por ndonjëherë mund të zgjasin me vite. Ngjarjet El Niño dhe La Niña ndodhin mesatarisht çdo dy deri në shtatë vjet, por ato nuk ndodhin sipas një orari të rregullt. Në përgjithësi, El Niño ndodh më shpesh se La Niña.

C3S multi-system seasonal forecast
 Prob(most likely category of 2m temperature)
 Unweighted mean


ECMWF/Met Office/Météo-France/CMCC/DWD/NCEP/JMA/ECCC
 JJA 2023

Nominal forecast start: 01/05/23




C3S: ECMWF contribution
 Prob(most likely category of 2m temperature)
 Ensemble size = 51, climate size = 600

JJA 2023



C3S: DWD contribution
 Prob(most likely category of 2m temperature)
 Nominal forecast start: 01/05/23
 Ensemble size = 50, climate size = 720


JJA 2023



Modelet CS3, ECMWF, DWD, tregojnë afërsisht ngjarje të njëjta gjatë 3 muajve të ardhshëm, kjo nënkupton që sipas këtyre modeleve, vera 2023 në Kosovë, do të karakterizohet me temperatura (2m), më të larta (40 – 60 %), mbi mesataren për muajt e verës. Ndërsa sipas modeleve, pjesë tjera të Evropës jugore, të Evropës qendrore dhe perëndimore, do të përballen me temperatura edhe më të larta.


C3S: ECMWF contribution
 Prob(most likely category of precipitation)
 Nominal forecast start: 01/05/23
 Ensemble size = 51, climate size = 600

JJA 2023



Sa i përket reshjeve, siç shihet nga modeli i mësipërm (ECMWF), tregon që Kosova, gjatë muajve të verës do të ketë deficit të reshjeve, nën mesataren shumëvjeçare për muajt e verës.

Figura 1 Parashikimi i reshjeve për muajt qershor – Korrik – gusht – shtator



Legjenda e probabiliteteve për (a) kushtet normale dhe (b) ekstremet.


Reshjet përkufizohen si shuma e reshjeve të lëngshme dhe të ngurta dhe shprehen si ekuivalente vëllimore të reshjeve të lëngshme. Të dhënat janë përpunuar duke përdorur korrjimin e lartësisë së modelit hidrologjik dhe interpolimin hapësinor. Për çdo periudhë mujore, treguesi i disponueshëm për reshjet bazuar në të dhënat ditore është: Mesatarja mujore: mesatarja e periudhës së plotë mujore e të gjitha vlerave ditore Të dhënat bazohen në parashikimet e reshjeve sezonale të rregulluara sipas modelit HYPE.

Duke u bazuar në model, vërehet që sipas dyja skenarëve (a dhe b), gjatë muajve korrik dhe gusht, sidomos pjesa perëndimore e Kosovës, do të ketë “më pak se i ulët”, ndërsa pjesa qendrore “mesatare”, kurse në Anamoravë “e ulët”. Ndërsa për muajt kusht – shtator vetëm pjesa jugore e Dukagjinit, probabiliteti do të jetë me i ultë se mesatarja, ndërsa për pjesën më të madhe të vendit ajo do të jetë “mesatare” të reshjeve për këta muaj.

Parashikimet për rrjedhat lumore në Kosovë


Sasia e reshjeve e cila ka rënë deri më tani (janar – maj), rreth 300 mm, si dhe ajo e borës në zonat më të larta malore (>800 m), e rënë së voni) mars – prill 2023, e cila në masë të caktuar, akoma është prezente në zonat e larta malore (>1500 m), në Malet e Sharrit, dhe Alpet Shqiptare, është tregues që edhe gjatë verës, pjesa më e madhe e lumenjve të cilat e kanë burimin dhe ushqehen nga këto zona, do të kenë rrjedha më të qëndrueshme dhe kështu, nivelet dhe prurjet e ujit nëpër lumenjtë kryesorë të Kosovës, to të kenë afërsisht rrjedhë afër mesatares sezonale. Harta 1, paraqet trashësinë e borës për Kosovë, në të cilën shihen zona e Alpeve Shqiptare dhe Malet e Sharrit, në të cilat në disa pjesë të tyre akoma ka shtresë bore, e cila tregon që shtresa dhe sipërfaqja, janë në suaza afërsisht të normales për këtë periudhë (Maj 2023)

Harta 1 Zonat aktualisht të mbuluara me shtresë bore



Devijimi i matur i thellësisë mesatare të borës 10-ditore të nxjerrë nga LISFLOOD nga kushtet referuese 'normale' për datën e specifikuar. Kushtet normale janë nxjerrë duke përdorur ekuivalentin e simuluar të ujit të borës (SWE) për një model klimatologjik 27-vjeçar (1990-2017).


Harta 2. Ekuivalenti i ujit të borës



Përshkrimi: LISFLOOD simuloi sasinë e borës [mm ekuivalent uji] bazuar në të dhënat meteorologjike të vëzhguara.

Në imazhet e më sipërm (hartat 2), kryesisht në zonën e Alpeve Shqiptare dhe në disa pjesë të Sharrit, sidomos shpatijet jugore të tyre. shihet shtresë bore me përmbajtje ekuivalente nga 25 deri 125 mm ujë, e cila natyrisht me ngritjen e temperaturave dhe rritjen e gradientit termik vertikal, çdo ditë e më tepër do të pakësohet.


Harta 3 Lagështia e tokës




Përshkrim: Devijimi i matur i lagështisë së tokës simuluar nga LISFLOOD nga kushtet referuese 'normale' për datën e specifikuar. Kushtet normale janë nxjerrë duke përdorur lagështinë e simuluar të tokës nga një model klimatologjik 27-vjeçar (1990-2017).

Aktualisht, deficit të lagështisë në tokë, apo “më thatë se sa normal”, kemi në pjesën qendrore të Rrafshit të Kosovës, konkretisht Rrethina e Prishtinës, Obiliqit, Fushë Kosovës, Lipjan e gati deri në Ferizaj. Ndërsa në disa pjesë të Dukagjinit, kryesisht përgjatë rrjedha të mesme të lumenjve, kemi “shumë më tepër ujë se normal”, ndërsa në pjesën më të madhe të Kosovës aktualisht (Maj), “Më lagësht se normalja”.

Grafiku 2. Trendet aktuale dhe parashikimi i rrjedhës së Lumit Drini Bardhë



Parashikimi i rrjedhave lumore për muajt qershor- korrik – gusht - shtatorë



Mesatarja mujore e parashikuar është llogaritur për çdo ujëmbledhës. Shërbimi përditësohet çdo muaj kur bëhen të disponueshme parashikimet e reja sezonale. Treguesit e ndikimit sezonal bazohen në modelimin e ndikimit hidrologjik duke përdorur modelin hidrologjik WW-HYPE. Modelimi hidrologjik sezonal është realizuar duke i rregulluar parashikimet e klimës të ofruara nga ECMWF. Më tej për "Reshjet" ka për qëllim të tregojë të dhënat duke përfshirë ndikimin e përpunimi paraprak të reshjeve (për p.sh. korrjimin e lartësisë ose interpolimin hapësinor).

Muaji qershor. Do të karakterizohet me rrjedha afër normales së tyre, ndërsa disa prej pellgjeve do të karakterizohen me mbi normale sipas modelit, ndërsa muaji korrik, në pjesën më të madhe të lumenjve e sidomos të atyre në pjesën lindore të vendit do të karakterizohen me rrjedha “nën normale sipas variacionit A të probabilitetit të modelit.

Muaji më i thatë në aspektin hidrologjik, parashihet të jetë gushti, i cili do të karakterizohet me rrjedha të ulëta, por mbi vlerat minimale mesatare, sidomos për pellgjet gjegjësisht lumenjtë e pjesës perendimore dhe veriore të vendit.

Konkluzion

- Në aspektin meteorologjik, muajt e verës do të karakterizohen me temperatura më të larta apo mbi mesataren shumëvjeçare, numri i ditëve me temperatura tropike (≥ 30), pritet të jetë në suaza të “normalës” dekatore, gjithnjë më e lartë se mesatarja shumëvjeçare.
- Po ashtu duke u bazuar në modelet e ndryshme dhe kushtet e përgjithshme sinoptike, sidomos të muajve prill - majë, të cilët janë karakterizuar me reshje, në masë të konsiderueshme, kanë ndikuar edhe në një stabilitet, gjegjësisht qëndrueshmëri të rrjedhave lumore, të cilat në vendin tonë kanë regjim të kombinuara, ngase furnizohen nga reshjet e shiut dhe shkrirja e borës. Këto kushte fillimisht meteorologjike dhe klimatike do të ndikojnë pozitivisht edhe në qëndrueshmëri të rrjedhave ujore, por edhe në mbushjen e akuifereve gjegjësisht të ujërave nëntokësorë edhe për muajt e ardhshëm.
- Regjimi aktual dhe trendet për muajt në vijim, parashikojnë një stabilitet apo qëndrueshmëri hidrike, sidomos të mbushjes së rezervuarve gjegjësisht akumulacioneve ujore në tërë vendin, me që rast edhe stabilitet në furnizim me ujë.
- Ndërsa në anën tjetër amplitudat e temperaturave sidomos gjatë muajve të verës, për të cilat parashikohet që të jenë mbi vlerat mesatare shumëvjeçare, do të kenë ndikime dhe efekte të ndryshme.